



GJAKOVA



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bazë të nenit 8 paragrafi 3.2, të rregullores 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Për dy përfaqësues nga grupi i Ekspertëve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e rinisë, të publikuar me datë: 30.03.2026 me titull:

Thirrje Publike për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve të Rinisë.

DKRS, fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar duhen t'i plotësojnë këto kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë);
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë);
3. Njohja e dokumenteve strategjik dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë);
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë);
5. Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20 pikë);
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë);
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pikë).

Afati i aplikimit: 07.04.2026 deri 17.04.2026.

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kritere:

Duhet të kenë diplomë universitare;

Të kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".